



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
  
**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



**EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së jashtëzakonshme, mbajtur më 08.05.2020, e cila filloj në orën 16:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Bashkim Beha (PSD), Drilon Pireva (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Nol Nushi (PSD), Visare Gashi (PSD), Adrian Berisha (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Valbona Petrovci (e pavarur), Leonora Shabani – Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Nazlie Bala, (LVV), Egzon Azemi (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Elmire Nikçi – Rexha (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Shefki Gashi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Jeta Rafuna – Hasani (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Suzan Kika, (PDK), Yll Bogaj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (e pavarur), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR), Sami Boroci, (AKR), Arbenita Murseli (AKR), Adelina Fazliji (AKR), Rifat Deri (i pavarur) dhe Sokol Berisha (i pavarur).

**Munguan:** Naime Osmani (LDK), Naim Hoxha (LVV), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Baton Dushi (Nisma) dhe Migjen Shala (PDK).

**Të pranishëm ishin edhe:** Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës, Muhedin Nushi, nënkyrytar i Komunës, Blerta Basholli, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Bujar Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Valbona Osmani, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit, Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Fitim Rexha, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Vasilika Zotaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, përfaqësues të mediave elektronike.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoj **Agim Kuleta**, kryesues i Kuvendit, dhe propozoi këtë

## R E N D D I T E:

### 1. Informatë nga Kryetari i Komunës rrëth menaxhimit të situatës së pandemisë Sars-Covid- 19 në komunën e Prishtinës.

#### Pika e parë

#### Informatë nga Kryetari i Komunës rrëth menaxhimit të situatës së pandemisë Sars - Covid-19 në komunën e Prishtinës.

Para se të fillonin me diskutimet e pikës së rendit të ditës, kryetari, **Shpend Ahmeti**, kërkoi nga të pranishmit që të mbahet një minutë heshtje për viktimat e Covid-19. Kryetari fillimisht i falënderoi të gjithë pjesëmarrësit, të cilët u angazhuan në dhënien e ndihmave në forma të ndryshme për tejkalimin gjendjes si pasoj e Covid- 19. Të gjitha ato që janë vendosur në mbledhjen e kaluar, që e kemi quajtur pako "Prishtina 1", janë ekzekutuar. Jemi duke shpërndarë ndihmat dhe pakot higjenike për të gjitha familjet që janë lajmëruar si raste sociale. Po ashtu, i kemi subvencionuar edhe ato ndërmarrje ku është dashtë gjithsesi të intervenohet, por do të intervenojmë edhe në disa biznese ku ka defekte, si dhe do të digitalizohen të gjitha shkollat. Kemi filluar punët në investime kapitale, posaçërisht me punët e kontraktuara që kanë qenë. Me Ministrinë e Financave jemi në kontakt të vazhdueshëm dhe kemi diskutuar për zbutjen e masave. Sa i përket kohës së qëndrimit në karantinë, tanj ajo do të jetë 7 ditë. Gjithashtu, duhet ndihmuar edhe NPL "Sport Marketing" dhe disa klube kryesore që kanë vështirësi financiare.

Kemi diskutuar me ministrin Vitia për lehtësimin e gjérave, varësisht nga situata.

**Agim Gashi** kërkoi të dijë se a është bërë ndonjë ndërhyrje në fushën e bujqësisë, në subvencionimin e tyre, përcjelljen e mbjelljeve dhe trajtimin e rezervave.

**Egzon Azemi** theksoi se në bazë të disa informacioneve që i kemi, nuk janë paguar pagat për punëtorët e çerdheve me bazë dhe komunitet. Po ashtu, banorët e lagjes "Kurti" në Barilevë kanë shprehur shqetësim për mungessë të ujit, sidomos në këtë situatë që jemi.

Një tjetër shqetësim është shprehur edhe nga punëtorët e parkingut "Prishtina", të cilët shprehin pakënaqësi për shkak të pagesave me dy standarde. Disa punëtorë të rinj që i ka sjellë Komuna me konkurs, po paguhen nga 350 euro, kurse punëtorët më të vjetër nga 250 euro.

**Sami Boroci** kërkoi të dijë se si kanë rrjedhur gjërat rrëth shpërndarjes së pakove emergjente për bizneset e vogla dhe kërkoi që të intervenohet sa më shpejt.

**Sami Salihu** pyeti se a ka mundësi që QKMF-të ta zgjasin orarin e punës, pasi që ato po punojnë vetëm me gjysmë orari.

**Arbenita Murseli** kërkoi nga ekzekutivi që familjeve në gjendje të rëndë ekonomike, t'u jepet nga një llaptop për fëmijët të cilët i kanë në shkolla, për përcjelljen e mësimit online në distancë.

**Fiknete Bejta** tha se Komiteti për zhvillim ekonomik dhe rural është funksional dhe i gatshëm të kontribuojë në këtë gjendje. Gjithashtu pyeti se a mund të shikohet buxheti, që për projekte të cilat janë "0", ta shohim mundësinë që ato t'i destinojmë aty ku ka nevojë.

Faqe 2 nga 3

**Hafiz Krasniqi** theksoi se, duke pasur parasysh se do të kemi mungesë të realizimit të projekteve kapitale, kërkoj nga stafi i Komunës që viti kalendarik 2021, të na gjejë të përgatitur, të jemi të gatshëm që në muajin mars të startohet me realizimin e projekteve. Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë kryetari, Shpend Ahmeti, dhe Bujar Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë.

Mbledhja përfundoi në orën 17:00.

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Agim Kuleta**



Faqe 3 nga 3